

**Doncafe Albania Sh.p.k.**

**Pasqyrat financiare  
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014  
(dhe raporti i audituesve te pavarur)**

---

## Përbajtja

---

Faqja

Raporti i Audituesve te Pavarur

Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014:

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te Tjera Permbledhese	2
Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4
Shenime per Pasqyrat Financiare	5 – 13

## Raporti i audituesve të pavarur

Aksionarit të  
Doncafe Albania Sh.p.k

Tiranë, 14 maj 2015

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Doncafe Albania Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financier më 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Për shkak të çështjeve të trajtuar në paragrafët e Bazës për Refuzim për të dhënë Opinion, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat për një opinion auditimi.

### Baza për Refuzim për të Dhënë Opinion

- Siç përshkruhet në shënimin 6 të pasqyrave financiare, aktivet jo materiale të Shoqërisë përfaqësohen nga emri i mirë prej 664,270,221 Lek (2013: 664,270,221 Lek). Trajtimi i emrit të mirë rishikohet në nivelin e grupit Strauss Coffee B.V. dhe çdo zhvlerësim në lidhje me të njihet vetëm në nivel grupi. Ky trajtim kontabël nuk është në përputhje me SNK 36 "Zhvlerësimi i Aktiveve", i cili kërkon që emri i mirë të testohet çdo vit për zhvlerësim dhe çdo humbje nga zhvlerësimi të njihet në fitim ose humbje. Rregullimet për emrin e mirë, tatumet dhe humbjen neto, të cilat do të kishin rezultuar si pasojë e zbatimit të SNK 36, nuk janë përcaktuar.
- Siç përshkruhet në Shënimin 10 të pasqyrave financiare, gjatë vitit 2008 Shoqëria ka marrë një hua afatgjatë, pa interes nga aksioneri i saj i vetëm. Shoqëria nuk i ka njojur huatë me vlerën e drejtë në njojen fillestare e më pas me kosto të amortizuar, megjithëse kjo është brenda qëllimit të SNK 39 'Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja'. Në vijim, Shoqëria nuk ka përgatitur shënimë shpjeguese për analizën e ndjeshmërisë dhe vlerës së drejtë, të cilat kërkohen nga SNRF 7 'Instrumentet Financiare: Shënimet shpjeguese'. Për shkak të natyrës së regjistimeve kontabël dhe në mungesë të dokumentacionit mbështetës të përshtatshëm, ne nuk mundëm të përcaktonim se çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- Shoqëria i njeh diferençat e kurseve të këmbimit valutor, që rrjedhin si pasojë e konvertimeve të huave nga aksionari i saj i vetëm, në të ardhura të tjera përbledhëse, të cilat janë pjesë përbërëse e kapitalit të Shoqërisë. Ky trajtim kontabël nuk është në përputhje me SNK 21 'Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimeve Valutore' i cili kërkon që diferençat në valutë të huaj që rrjedhin si pasojë e konvertimeve të zërave monetarë të njihen në fitim ose humbje. Po të ishte aplikuar një politikë e tillë, rezerva e rivlerësimit në shumën prej 135,678,860 Lek (2013: 129,357,289 Lek) do të ishte eliminuar, humbjet e tjera përbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 do të ishin zgjedhur dhe humbja neto do të ishte rritur me 6,321,571 Lek (2013: 1,699,874 Lek). Humbjet e mbartura në çelje do të ishin rritur me 129,357,289 Lek (2013: 127,657,415 Lek).

### *Refuzimi për të Dhënë Opinion*

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuar në paragrafët e Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion, ne nuk shprehim ndonjë opinion mbi pasqyrat financiare.

### *Theksim i Çështjes*

Pa modifikuar më tej opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen mbi Shënimin 14 të pasqyrave financiare, i cili sqaron se Shoqëria ka pësuar një humbje prej 2,547 Lek gjatë vitit (2013: 556,233 Lek) dhe ka kapital aksionar negativ prej 207,702,413 Lek më 31 dhjetor 2014 (2013: 201,378,295 Lek). Menaxhimi pohon se Shoqëria do të vazhdojë të mbështetet nga Grupi Strauss dhe si rrjedhojë pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.



Heris Jani  
Auditues Ligjor

KPMG Albania Sh.p.k.  
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.  
Twin Towers Buildings,  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

# Doncafe Albania Sh.p.k


## Pasqyra e pozicionit finansiar me 31 dhjetor

(Vlerat ne Leke)

	Shenime	2014	2013
<b>Aktive</b>			
Aktive afatgjata jo-materiale	6	664,270,221	664,270,221
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>664,270,221</b>	<b>664,270,221</b>
Kerkesa tregtare per arketim	13	2,975,869	3,008,487
Tatim fitimi i parapaguar		1,589,821	1,589,821
Kerkesa te tjera per arketim	7	3,532,573	3,532,573
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8	26,911,790	26,883,391
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>35,010,053</b>	<b>35,014,272</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>699,280,274</b>	<b>699,284,493</b>
<b>Kapitalet e veta</b>			
Kapitali aksioner	9	184,260,000	184,260,000
Rezerva e rivleresimit		(135,678,860)	(129,357,289)
Rezerva ligjore	9	1,586,983	1,586,983
Humbje te mbartura		(257,870,536)	(257,867,989)
<b>Totali i kapitaleve te veta</b>		<b>(207,702,413)</b>	<b>(201,378,295)</b>
<b>Detyrime</b>			
Huamarrje afatgjata	10	906,466,804	900,145,234
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>906,466,804</b>	<b>900,145,234</b>
Furnitore		294,336	296,705
Detyrime te tjera		221,547	220,849
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>515,883</b>	<b>517,554</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta</b>		<b>699,280,274</b>	<b>699,284,493</b>

Pasqyra e pozicionit finansiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjesë perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 13.

Keto pasqyra financiare u aprovaan nga Administratoret e Shoqerise me 31 Mars 2015 dhe u nenskruan ne emer te tyre nga:

  
 Andi Pacani  
 Perfaqesues i autorizuar nga Shoqeria



# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhuarave te tjera permblledhese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor**

*(Vlerat ne Leke)*

---

	<b>Shenime</b>	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Shpenzime te per gjithshme dhe administrative	11	(1,078,558)	(1,354,604)
<b>Rezultati nga veprimtarite shfrytezuese</b>		<b>(1,078,558)</b>	<b>(1,354,604)</b>
Te ardhura financiare		1,258,331	852,514
Shpenzime financiare		(182,320)	(54,143)
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(2,547)</b>	<b>(556,233)</b>
Tatimi mbi fitimin	12	-	-
<b>Humbja neto per vitin</b>		<b>(2,547)</b>	<b>(556,233)</b>
<b>Shpenzime te tjera permblledhese</b>			
<i>Zera qe jane ose mund te riklasifikohen si fitim ose humbje</i>			
Efekti i rivleresimit te huave afatgjata ne monedhe te huaj		(6,321,571)	(1,699,874)
<b>Totali i shpenzimeve permblledhese per vitin</b>		<b>(6,324,118)</b>	<b>(2,256,107)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera permblledhese duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjesë perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 13.

## Doncafe Albania Sh.p.K

### Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor

*(Vlerat ne Leke)*

	Kapitali aksioner	Rezerva e rivleresimit	Rezerva ligjore	Humbje te mbartura	Totali
<b>Gjendja me 1 Janar 2013</b>	<b>184,260,000</b>	<b>(127,657,415)</b>	<b>1,586,983</b>	<b>(257,311,756)</b>	<b>(199,122,188)</b>
<b>Totali i shpenzimeve permblledhese per vitin</b>	-	<b>(1,699,874)</b>	-	<b>(556,233)</b>	<b>(2,256,107)</b>
Humbja neto per vitin	-	-	-	<b>(556,233)</b>	<b>(556,233)</b>
Efekti i rivleresimit te huave afatgjata ne monedhe te huaj	-	-	-	-	<b>(556,233)</b>
<b>Kontribute nga pronaret dhe shperndarje pronareve</b>	-	<b>(1,699,874)</b>	-	-	<b>(1,699,874)</b>
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2013</b>	<b>184,260,000</b>	<b>(129,357,289)</b>	<b>1,586,983</b>	<b>(257,867,989)</b>	<b>(201,378,295)</b>
<b>Totali i shpenzimeve permblledhese per vitin</b>	-	<b>(6,321,571)</b>	-	<b>(2,547)</b>	<b>(6,324,118)</b>
Humbja neto per vitin	-	-	-	<b>(2,547)</b>	<b>(2,547)</b>
Efekti i rivleresimit te huave afatgjata ne monedhe te huaj	-	<b>(6,321,571)</b>	-	-	<b>(6,321,571)</b>
<b>Kontribute nga pronaret dhe shperndarje pronareve</b>	-	-	-	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2014</b>	<b>184,260,000</b>	<b>(135,678,860)</b>	<b>1,586,983</b>	<b>(257,870,536)</b>	<b>(207,702,413)</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjesë perberese te pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 13.

# Doncafe Albania Sh.p.k

## Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor

(Vlerat ne Leke)

	Shënime	2014	2013
<b>Flukse monetare nga veprimtari shfrytezuese</b>			
Humbja neto e vtit		(2,547)	(556,233)
Pakesim i kerkesave per arketim		32,618	6,014,095
Pakesim i llogarive te pagueshme		(1,672)	(37,177,383)
<b>Mjete monetare perdorur nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		<u>28,399</u>	<u>(31,719,521)</u>
<b>Mjete monetare nga veprimtarite investuese</b>		-	-
<b>Mjete monetare perdorur ne veprimtarite financuese</b>		-	-
<b>Pakesimi neto i mjeteve monetare</b>		<u>28,399</u>	<u>(31,719,521)</u>
Mjete monetare ne fillim te vtit		26,883,391	58,602,912
<b>Mjete monetare ne fund te vtit</b>	8	<u>26,911,790</u>	<u>26,883,391</u>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese dhe pjese perberese e pasqyrave financiare ne faqet 5 deri 13.

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

---

### **1. Informacion i pergjithshem**

Doncafe Albania Sh.p.k (“Shoqeria”) eshte filial i Strauss Coffee B.V, Rotterdam dhe rrjedhimisht filial i Strauss-Group Ltd (“Strauss-Group”), Israel.

Shoqeria u themelua me 30 Mars 2008 me vendim te bordit te drejtuesve ekzekutive te Strauss Coffee B.V. Shoqeria eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me 16 Prill 2008 si shoqeri me perjegjesi te kufizuar e zoteruar plotesisht nga Strauss Coffee B.V.

Me 13 Maj 2008, Shoqeria hyri ne nje Marreveshje Bjerje Biznesi me Don Café Sh.p.k me qellim per blerjen e aktivitetit te prodhimit dhe tregtimit te kafese.

Gjate vitit 2010 Shoqeria ndaloj prodhimin e kafese ne vend dhe gjate vitit 2011 pushoi edhe aktivitetin e shitjes se kafese. Aktualisht, aktiviteti i Shoqerise eshte i fokusuar ne mbledhjen e borxheve nga klientet e saj.

Me 31 dhjetor 2014 Shoqeria nuk ka te punesuar (2013: asnje punonjes). Administratori i Shoqerise eshte Z.Sinisa Danicic, i cili nuk eshte resident ne Shqiperi, por deklarohet ne administraten tatimore si i punesuar vetem per qellime tatimore.

### **2. Baza e pergatitjes**

#### **(a) Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare bashkangjitur jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

#### **(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

#### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten ne Leke, e cila eshte monedha funksionale per Shoqerine.

#### **(d) Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve**

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon qe drejtimi te kryeje gjykime, çmuarje dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te rapportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhme qe ndikohen.

Ne veçanti, informacion mbi elemente te rendesishem ne vleresimin e pasigurive dhe gjykime kritike per aplikimin e politikave kontabel qe kane efekt material ne vlerat kontabel ne pasqyrat financiare jepet ne shenimi 6 - Aktive afatgjata jomateriale. Gjithashtu inforamcion mbi parimin e vijueshmërisë eshte paraqitur ne shënimin 14.

### **3. Permbledhje e politikave kontabel**

#### **(a) Aktivet jo-materiale (*Emri i mire*)**

Emri i mire perfaqeson vleren shtese qe rezulton nga diferenca midis kostos se blerjes dhe vleres se drejte te pjeses se aktiveve te identifikueshme neto ne aktivitetin qe ka blere Shoqeria ne daten e blerjes. Emri i mire qe rezulton nga blerja e aktiviteteve perfshihet ne “aktivet jo-materiale”. Emri i mire testohet çdo vit per zhvleresime te mundshme dhe mbartet me kosto minus humbjet e akumuluara per zhvleresime. Humbjet nga zhvleresimi i emrit te mire nuk anullohen.

Emri i mire i bashkangjitet njesise gjeneruese te mjeteve monetare per qellime testimi per zhvleresim. Ai i bashkangjitet atyre njesive apo grupeve gjeneruese te mjeteve monetare te cilat pritet te perfitojne nga blerja e biznesit prej nga lindi fillimisht emri i mire.

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(b) Instrumentet financiare**

Shoqeria mban vetem instrumente financiare jo-derivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, huamarjet, dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative jane matur fillimi me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejt me pervesimin e tyre. Njohja ne vijim e instrumenteve financiare jo-derivative pershkruhet me poshte.

Nje instrument finanziar njihet ne rast se Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te Shoqerise ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi finanziar mbarojne, ose nese Shoqeria i transferon aktivin finanziar nje pale tjeter, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktivi finanziar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen Shoqeria zotohet te bleje ose te shese aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Shoqerise te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane annulluar

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijn vlerat ne arke, llogari rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra me maturitet original tre muaj ose me pak, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere, dhe perdoren nga Shoqeria ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

*Kerkesa per arketim*

Kerkesat per arketim njihen fillimi me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara per humbjet per zhvleresime.

*Llogari te pagueshme*

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

*Huamarrjet*

Huamarrjet nga aksioneret njihen fillimi me kosto. Huamarrjet e tjera njihen fillimi me vlere te drejte. Huamarrjet mbarten ne vijim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Te tjera*

Instrumenta financiare te tjere jo-derivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

Kontabilizimi per te ardhurat dhe shpenzimet financiare eshte diskutuar ne politiken kontabel 3(f).

#### **(c) Zhvleresimi i aktiveve financiare**

Nje aktiv finanziar konsiderohet i zhvleresuar nese nje evidence objektive tregon se nje ose me teper ngjarje qe kane ndodhur kane patur nje ndikim negativ ne flukset e çmuara te ardhshme te mjeteve monetare te aktivit finanziar.

Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi finanziar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si difference ndermjet vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te mjeteve monetare, skontuar me normen fillestare te interesit efektiv te aktivit finanziar.

Aktivet financiare te cilat jane te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vleresohet bashkarisht ne grupe qe mbartin karakteristika te ngjashme risku. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje. Nje humbje zhvleresimi mund te anullohet nese ulja ne zhvleresim ka ndodhur per shkak te nje ngjarjeje qe ka ndodhur pasi eshte njojur zhvleresimi. Anullimi njihet ne fitim ose humbje.

#### **(d) Kapitali aksioner**

Kapitali aksioner i Shoqerise njihet me vleren nominale.

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(e) Shpenzimet operacionale**

Shpenzimet operacionale njihen ne momentin kur ato ndodhin.

#### **(f) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi prej llogarive ne banka dhe fitimet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit, komisionet bankare dhe humbjet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen ne fitim ose humbje duke perdorur metoden e interesit efektiv.

#### **(g) Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin ose humbja e vtit perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje perveç pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera permbledhese.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatushem te vtit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit, dhe cdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Ne percaktimin e shumes se tatimit aktual dhe te shtyre Shoqeria merr ne konsiderate impaktin me pozicione tatimore te pasigurta dhe nese tatime apo interesa shtese mund te paguhen. Shoqeria beson se perllogaritjet per detyrimet tatimore jane te pershatashme per te gjithe vitet e hapura tatimore bazuar ne vleresimet e shume faktoreve qe perfshijne implementimin e legjislacionit tatimor dhe eksperiencat e meparshme. Informacione te reja mund te behen te vlefshme dhe shkak qe Shoqeria te ndryshoje gjykimin ne lidhje me pershatshmerine e detyimeve tatimore aktuale; te tilla ndryshime ne detyime tatimore do te ndikojne ne shpenzimet tatimore ne periudhen qe ky percaktim eshte bere.

Tatimi i shtyre eshte llogaritur duke perdorur metoden e detyrimit ne bilanc, nga diferenca e perkozhshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatushem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit aktiv te mund te perdoret. Aktivi tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfisit fiskal.

#### **(h) Transaksionet ne monedha te huaja**

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i kembimit per zerat monetare eshte diferenca ndermjet kostove te amortizuara ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kostove te amortizuara ne monedhe te huaj te konvertuara me kursin e kembimit ne fund te periudhes. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vlore te drejte konvertohen ne monedhe funksionale me kursin e kembimit ne daten kur eshte vendosur vlera e drejte. Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne fitim ose humbje, perveç diferencave nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi i huave nga aksioneret te cilat njihen ne te ardhurat permbledhese.

#### **(i) Standarde dhe interpretime te reja ende te pa-adoptuara**

Nje numer standardesh te reja, ndryshime ne standarde dhe interpretime nuk jane ende efektive per periudhen qe mbyllte me 31 dhjetor 2014, dhe nuk jane aplikuar ne perqatitjen e ketyre pasqyrave financiare. Asnje prej tyre nuk do te kete ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

### **4. Percaktimi i vlerës së drejtë**

Nje numer i caktuar politikash kontabël dhe shenimesh shpjeguese te Shoqerise kerkojne përcaktimin e vleres se drejtë per aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë eshte përcaktuar per matjet dhe/ose per qellime shpjeguese bazuar ne metodat e meposhteme. Kur aplikohen, informacionet e mëtejshme rreth supozimeve te bera ne përcaktimin e vleres se drejtë jepen ne shenimet shpjeguese te aktivit ose detyrimit:

#### *Aktivet financiare te matura me koston e amortizuar*

Vlera e drejtë e klienteve dhe kërkesave te tjera te arketueshme vleresohej me vleren aktuale te flukseve te ardhshme e skontuar me normen e interesit te tregut ne daten e raportimit. Vlera e drejtë përcaktohet per qellime shpjeguese.

#### *Detyrimet financiare te matura me koston e amortizuar*

Vlera e drejtë qe eshte përcaktuar per qellime shpjeguese, llogaritet duke u bazuar ne vleren aktuale te prialit dhe interesave te flukseve monetare te ardhshme te skontuara me normen e interesit te tregut ne daten e raportimit.

Vlera e drejtë e mjetave monetare dhe ekivalenteve me to, llogarive te arketueshme dhe te pagueshme eshte perafërsisht te barabarte me vleren kontabël per shkak te maturitetit te tyre afatshkurter.

Huaja e marre nga aksioneret e Shoqerise eshte pa interes (shiko shënimin 10). Drejtuesit nuk jane perpjekur te vleresojne huane me vleren e drejtë bazuar ne një llogaritje te normes efektive te interesit.

### **5. Menaxhimi i riskut financiar**

Shoqeria eshte ekspozuar ndaj rreziqeve te meposhtme nga perdonimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredise
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shenim paraqet informacion rreth ekspozimit te Shoqerise ndaj secilit prej rreziqeve te mesiperm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqerise per matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shenime te mëtejshme sasiore jane perfshire ne keto pasqyra financiare.

Administratoret e Shoqerise kane perjegjesi te gjithanshme per vendosjen dhe monitorimin e kuadrit te manaxhimit te riskut.

Politikat e drejtimit te riskut te Shoqerise jane krijuar per te identifikuar dhe analizuar riskun me te cilin perballët shoqëria, per te vendosur limite dhe kontolle te përshtatshme, per te monitoruar riskun dhe zbatimin e limiteve.

Instrumentat kryesore financiare te Shoqerise konsistonë ne mjetet monetare ne arke dhe ne banke, huamarrjet, llogarite tregtare te arketueshme dhe te pagueshme.

#### *(i) Risku i kredise*

Risku i mos-pageses ekziston kur pala tjeter nuk mund te permbsuhe detyrimet per pagesen e llogarive te arketueshme.

Maksimumi i riskut te kredise per instrumentet financiare jo-derivative eshte teorikisht i barabarte me vleren e drejtë te te gjitha llogarive te arketueshme minus detyrimet kundrejt te njejtit debitor kur kompensimi eshte i lejuar. Risku i kredise i cili eshte identifikuar merret parasysh nepermjet zhvleresimeve.

#### *(ii) Risku i likuiditetit*

Shoqeria duhet te permbsuhe nevojat per mjetet monetare, kryesisht per kostot e shfrytezimit qe rrjedhin nga aktivitetet e saj. Ekziston rreziku qe mjetet monetare mund te mos jene te disponueshme per te shlyer detyrimet ne kohen e duhur me nje kosto te arsyeshme. Shoqeria monitoron likuiditetin ne baza periodike ne menyre qe te menaxhoje detyrimet e saj kur ato kerkohen.

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

### **5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

#### *(iii) Risku i tregut*

##### *Risku i normave te interesit*

Shoqeria nuk disponon instrumente financiare me interes me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013. Huamarrjet me palet e lidhura jane pa interes.

##### *Risku i kursit te kembimit*

Shoqeria ndermerr transaksione ne Leke, Euro dhe USD. Risku i pozicionit valutor menaxhohet nepermjet parimit te perputhjes se aktiveve me detyrimet. Megjithate, Shoqeria ka nje detyrim financiar neto te percaktuar ne Euro, i cili mund te rezultoje ne levizje valute te paperputhura kur perkthehet ne Leke. Shoqeria nuk ka hyre ne ndonje marreveshje derivative per kontrata te ardhshme shkembimi me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013.

##### *Analiza e ndjeshmerise*

Me anen e menaxhimit te riskut te normave te interesit dhe te pozicionit valutor, Shoqeria synon te redukoje ndikimin e luhatjeve afatshkurtra ne fitimet e Shoqerise.

#### *(iv) Menaxhimi i kapitalit*

Shoqeria nuk eshte subjekt i kerkesave te kapitalit te vendosura nga ente rregullatore. Shoqeria mbeshtetet nga aksioneri i vetem Strauss Coffee B.V.

### **6. Aktive afatgjata jo-materiale**

Aktive afatgjata jo-materiale prej 664,270,221 Leke perfaqesojne emrin e mire njohur si rezultat i blerjes se biznesit te prodhimit dhe tregtimit te kafese me 13 Maj 2008. Trajtimi i emrit te mire rishikohet ne nivelin e grupit Strauss Coffee B.V dhe ndonje zhvleresim i rezultuar njihet vetem ne nivel grupi.

### **7. Kërkesa te tjera per arketim**

Kerkesat e tjera per arketim perfshijne sa me poshte:

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
TVSH e rimbursueshme	1,968,148	1,968,148
Te tjera	1,564,425	1,564,425
<b>Totali</b>	<b>3,532,573</b>	<b>3,532,573</b>

### **8. Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjete monetare dhe ekuivalente perbehen si me poshte:

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Llogari rrjedhese		
Ne Leke	-	4,363,152
Ne USD	-	3,039
Depozita me afat		
Ne Leke	18,500,000	15,000,000
Ne USD	8,411,790	7,445,966
Ne EUR	-	71,234
<b>Total</b>	<b>26,911,790</b>	<b>26,883,391</b>

### **9. Kapitali aksionar**

Me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 kapitali themeltar eshte 184,260,000 Leke i ndare ne 184,260 aksione te zakonshme me vlore nominale 1,000 Leke secili, ndersa Rezervat ligjore jane ne shumen 1,586,983 Leke.

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

### **10. Huamarrje afatgjata**

Huamarrjet afatgjata perfshijne huate nga aksionari. Me 13 Maj 2008, aksionari i vetem dhe Shoqeria hyne ne nje marreveshje huaje sipas se ciles aksionari i vetem i akordoi Shoqerise nje hua me vlore deri ne ekuivalenten e 7,000 mijë Euro-ve me norme interes 0%. Koha per ripagimin e huase ishte 5 vjet nga data e disbursimit, e cila eshte shtyre me tej ne afat te pacaktuar. Me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 Shoqeria kishte 500,000 USD te kthyer ne 57,615,000 Leke (2013: 500,000 USD te kthyer ne 50,930,000 Leke) dhe 6,057,170 Euro te kthyer ne 848,851,804 Leke (2013: 6,057,170 Euro te kthyer ne 849,215,234 Leke) si hua pa interes nga aksioneri i saj.

### **11. Shpenzime te pergjithshme dhe administrative**

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Kontribute per sigurimet shoqerore	423,986	422,953
Keshillim teknik, kontabel, audit dhe ligjor	607,452	558,820
Taksa vendore	47,120	47,121
Tatim ne burim	-	325,710
<b>Total</b>	<b>1,078,558</b>	<b>1,354,604</b>

### **12. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi te ardhurat ne Shqiperi vleresohej me normen 15% mbi te ardhurat e tatushme (2013: 10%). Me poshte paraqitet rakordimi i tatimit mbi te ardhurat te llogaritur me normen e aplikueshme tatimore, me shpenzimin tatimor:

	<b>Norma efektive e tatimit</b>	<b>2013</b>	<b>Norma efektive e tatimit</b>	<b>2012</b>
Humbja para tatimit		(2,547)		(556,233)
Tatimi fillestar me 15%/ 10%	15%	(382)	10%	(56,323)
Shpenzime te panjohura per efekte tatimore	(15%)	382	(10%)	56,323
<b>Tatimi mbi fitimin</b>		-		-

# **Doncafe Albania Sh.p.k**

## **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

### **13. Instrumentat financiare**

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut te kredise**

Vlera kontabel e aktiveve financiare perfaqeson ekspozimin maksimal ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi maksimal ne daten e raportimit ishte:

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Kerkesa tregtare per arkëtim	2,975,869	3,008,487
Kerkesa te tjera per arkëtim	3,532,573	3,532,573
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	26,911,790	26,883,391
	<b>33,420,232</b>	<b>33,424,451</b>

#### **Humbje nga zhvleresimi**

Analiza sipas vjetërsise e kerkesave per arketim ne daten e raportimit eshte:

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Me shume se 90 dite ne vonese	134,834,584	134,867,202
<b>Vlera bruto</b>	<b>134,834,584</b>	<b>134,867,202</b>
Provizion per zhvlerësim	(131,858,715)	(131,858,715)
<b>Gjendje ne fund te vtit</b>	<b>2,975,869</b>	<b>3,008,487</b>

Ndryshimi ne balancen e te arketueshmeve lidhet me ndryshimin nga kursi i këmbimit gjatë 2014.

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut te likuiditetit**

Me poshtë paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit te mbetur me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013:

	<b>2014</b>				
	<b>Deri ne 6 muaj</b>	<b>6 deri ne 12 muaj</b>	<b>1 deri ne 5 vjet</b>	<b>Mbi 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
Kerkesa tregtare per arketim	2,975,869	-	-	-	2,975,869
Kerkesa te tjera per arketim	3,532,573	-	-	-	3,532,573
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	26,911,790	-	-	-	26,911,790
	<b>33,420,232</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>33,420,232</b>
Hua afatgjata	-	-	906,466,804	-	906,466,804
Furnitore	294,336	-	-	-	294,336
Detyrime te tjera	221,547	-	-	-	221,547
	<b>515,883</b>	<b>-</b>	<b>906,466,804</b>	<b>-</b>	<b>906,982,687</b>
<b>Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2014</b>	<b>32,904,349</b>	<b>-</b>	<b>(906,466,804)</b>	<b>-</b>	<b>(873,562,455)</b>

# Doncafe Albania Sh.p.k

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014

(Vlerat ne Leke)

### 13. Instrumentat financiare (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj rrezikut te likuiditetit

	2013				
	Deri ne 6 muaj	6 deri ne 12 muaj	1 deri ne 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Kerkesa tregtare per arkëtim	3,008,487	-	-	-	3,008,487
Kerkesa te tjera per arkëtim	3,532,573	-	-	-	3,532,573
Mjete monetare dhe ekuivalente	26,883,391	-	-	-	26,883,391
	<b>33,424,451</b>	-	-	-	<b>33,424,451</b>
Hua afatgjata	-	-	900,145,234	-	900,145,234
Furnitore	296,705	-	-	-	296,705
Detyrime te tjera	220,849	-	-	-	220,849
	<b>517,554</b>	-	<b>900,145,234</b>	-	<b>900,662,788</b>
<b>Rreziku i likuiditetit me</b>					
<b>31 Dhjetor 2013</b>	<b>32,906,897</b>	-	<b>(900,145,234)</b>	-	<b>(867,238,337)</b>

#### Ekspozimi ndaj rrezikut valutor

Ekspozimi i Shoqerise ndaj rrezikut valutor ne 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 eshte si me poshtë:

	2014		
	EUR	USD	LEKE
Kerkesa tregtare per arketim	2,975,869	-	-
Kerkesa te tjera per arketim	-	-	3,532,573
Mjete monetare dhe ekuivalente	-	8,411,790	18,500,000
	<b>2,975,869</b>	<b>8,411,790</b>	<b>22,032,573</b>
			<b>33,420,232</b>
Hua afatgjata	848,851,804	57,615,000	-
Furnitore	-	-	294,336
Detyrime te tjera	-	-	221,547
	<b>848,851,804</b>	<b>57,615,000</b>	<b>515,883</b>
			<b>906,982,687</b>
<b>Rreziku valutor me</b>			
<b>31 Dhjetor 2014</b>	<b>(845,875,935)</b>	<b>(49,203,210)</b>	<b>21,516,690</b>
			<b>(873,562,455)</b>

	2013		
	EUR	USD	LEKE
Kerkesa tregtare per arketim	3,008,487	-	-
Kerkesa te tjera per arketim	-	-	3,532,573
Mjete monetare dhe ekuivalente	71,234	7,449,004	19,363,153
	<b>3,079,721</b>	<b>7,449,004</b>	<b>22,895,726</b>
			<b>33,424,451</b>
Hua afatgjata	849,215,234	50,930,000	-
Furnitore	-	-	296,705
Detyrime te tjera	-	-	220,849
	<b>849,215,234</b>	<b>50,930,000</b>	<b>517,554</b>
			<b>900,662,788</b>
<b>Rreziku valutor me</b>			
<b>31 Dhjetor 2013</b>	<b>(846,135,513)</b>	<b>(43,480,996)</b>	<b>22,378,172</b>
			<b>(867,238,337)</b>

## **Doncafe Albania Sh.p.k**

### **Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014**

*(Vlerat ne Leke)*

#### **13. Instrumentat financiare (vazhdim)**

Kurset e kembimit ne fund te periudhes raportuese jane si me poshte (Lek me monedha te huaja):

	<b>31 Dhjetor 2014</b>	<b>31 Dhjetor 2013</b>
1 USD	115.23	101.86
1 Euro	140.14	140.20

#### **14. Vijueshmeria**

Shoqeria ka pesuar humbje per vitin prej 2,547 Leke (2013: 556,233 Leke) dhe ka kapital neto negativ prej 207,702,413 Leke më 31 dhjetor 2014 (2013: 201,378,295 Leke). Drejtuesit pohojne se Shoqeria do te vazhdoje te mbeshtetet nga grupi Strauss dhe si rrjedhoje llogarite jane perqatitur mbi bazen e parimit te vijueshmerise.

#### **15. Palet e lidhura**

Palet e lidhura konsiderohen se perfshijne aksionarin e vetem Strauss Coffee B.V. dhe grupin e kompanive te Strauss Coffee B.V.

Gjate vitit, ne rrjedhjen normale te biznesit Shoqeria ka kryer nje numer te caktuar transaksionesh me palet e lidhura. Volumi i ketyre transaksioneve dhe gjendjet e balancave ne fundin e periudhave perkatese jane si me poshte:

	<b>2014</b>	<b>2013</b>
Hua nga Strauss Coffee B.V	906,466,804	900,145,234
<b>Totali i huave nga palet e lidhura</b>	<b>906,466,804</b>	<b>900,145,234</b>

#### **16. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara**

Shoqeria nuk ka angazhime dhe detyrime te kushtezuara me 31 Dhjetor 2014.

#### **17. Ngjarjet pas dates se raportimit**

Drejtimi i Shoqerise nuk eshte ne dijeni te ndonje ngjarje pas dates se raportimit e cila mund te kerkonte rregullime ose shenime shpjeguese shtese ne pasqyrat financiare.